

RAPORT I AUDITUESIT TE
P A V A R U R
E D U A R T K I L A
P E R S O N F I Z I K
N . I . P . T . N r . K 3 2 6 . 2 6 2 . 1 0 . A
L A G J J A 5 M A J . P A L L A T I 5 0 0 / 2
E L B A S A N

ELBASAN 25.01.2012

KOMISIONIT QENDROR TE ZGJEDHJEVE
T I R A N E

ZONJA DHE ZOTERINJ ANETARE TE KOMISIONIT QENDROR TE
ZGJEDHJEVE :

Ne zbatim te detyrave te percaktuara ne Vendimin e Komisionit Qendror te Zgjedhjeve ne Republiken e Shqiperise Nr.1232 Dt.07.11.2011 , une ,Eduart Myrteza Kila ,ekspert kontabel i pavarur, licencuar nga Instituti i Eksperteve Kontabel te Autorizuar ne Tirane, me licence Nr.49 Dt 10.02.2000,jam caktuar per auditimin e shpenzimeve dhe te ardhurave te Partise se Punes se Shqiperise se Organizuar, ne fushaten zgjedhore , te pushtetit lokal te vitit 2011 . Sa siper paraqes raportin tim , ne konkluzion te auditimit ligjor te detyrueshem per fondet e perfituara dhe shpenzuara nga Partia se Punes se Shqiperise se Riorganizuar, ne vitin 2011.

Une kam kerkuar per te audituar evidencat parciale te Partise se Punes se Shqiperise se Organizuar, te cilat perfshijne veprimtarine financiare te periudhes per fushaten zgjedhore ne pushtetin lokal,ku perfshihen levizjet ne C.A.Sh, te arkes e bankes , per periudhen e mbyllur ne kete subjekt, fund te muajve prill- qershor, si dhe informacione te tjera shpjeguese.

PERGJEGJESIA E DREJTIMIT PER PASQYRAT E HARTUARA.

Drejtimi eshte pergjegjes per pergatitjen e ketyre pasqyrave ne pajtim me dispozitat e raportimit financiar dhe hartimin e zbatimin e rregulloreve perkatese dhe per kete qellim.Drejtimi ka vendosur kontroll te mbrendeshem qe ai ka gjykuar te nevojshem per te bere te mundur hartimin e pasqyrave te siper cituara ne menyre qe ato te mos permbajne anomali materiale per shkak te mashtrimit ose gabimit.

PERGJEGJESIA E AUDITUESIT

Pergjegjesia ime eshte te shpreh nje opinion mbi evidencat e krijuara bazuar ne auditimin e kryer.Une kam kryer auditimin ne pajtim me Standartet Nderkombetare te Auditimit.Keto standarte kerkojne qe te veproje ne pajtim me kerkesat e etikes dhe te planifikoj e kryej auditimin per te marre siguri te aresyeshme qe keto evidenca nuk permbajne anomali materiale.

Auditimi perfshin , kryerjen e procedurave per te siguruar nje evidence te auditimit ne lidhje me shumat dhe informacionet shpjeguese ,te dhena ne evidencat e krijuara.Procedurat e zgjedhura jane sipas gjykimit tim dhe perfshijne vleresimin e rreziqeve te anomalise materiale te evidencave te krijuara, si per shkak te mashtrimit apo gabimeve materiale.

Sa siper une besoj se evidenca e auditimit qe kam siguruar eshte e mjaftueshme dhe e pershtateshme per te dhene bazat e opinionit tim mbi auditimin e kryer.

O P I N I O N I

Sipas opinionit tim pasqyrat e kerkuara dhe hartuara japin realitetin e te ardhurave e shpenzimeve te kryera ne periudhen perkatese.

Keto pasqyra nuk jane te pershtatshme per ndonje qellim tjetër por vetem si evidence per te arritur konkluzion se si jane bere shpenzimet e si jane krijuar te ardhurat ne kete Institucion.Partia e Punes se Shqiperise e Organizuar, nuk ka te ardhura dhe shpenzime te evidentuara ne llogarite e saj.Kjo parti eshte pjesemarrese ne zgjedhjet lokale te vitit 2011 dhe shpenzimet e kryera nga kandidatet e saj kane qene te perballuara nga vete Kandidatet, pa financime te tjera te jashteme apo entitete .Ato jane mbuluar direkt nga kandidatet dhe kane qene shpenzime ne lokale ,shpenzime te vogla xhepi personal, kjo,sipas takimeve te kryera.

CESHTJE TE PERGJITHSHME

Institucioni perkates duhet te hartoje politika evidentimi , ne raste te tilla sipas standarteve te kerkuara nga Shteti Shqipetar, duke percaktuar politikat kontabile sipas kerkesave ligjore.

Sa siper bashkengjis nje fotokopje te dokumentave qe gjykoj se jane te nevojshem per Ju.

Sipas kontrates se perpiluar jam i gatshem te paraqitem tek Ju, per cdo sqarim.

EKSPER KONTABEL I AUTORIZUAR
E D U A R T K I L A

LAGJJA 5 MAJ
PALLATI 500/2
CEL 0682161770
E L B A S A N